REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 181, datë 31.08.2018

PËR
MIRATIMIN E AGJENTËVE NË SIGURIME, NË EMËR DHE PËR LLOGARI TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT "SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA" SH.A.

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 4, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", i ndryshuar, të nenit 194, pika 4, të nenit 195, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit", si dhe të Rregullores nr. 79, datë 31.08.2015 "Për miratimin/licencimin e personave për të ushtruar veprimtarinë e agjentit në sigurime si dhe rastet e mospranimit të regjistrimit të tij dhe refuzimit të licencës", me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. **Licencimin e subjektit "Bajraktari Mob" sh.p.k., për ushtrimin e veprimtarisë së agjentit në sigurime, në klasat e Jo-Jetës, në emër dhe për llogari të shoqërisë së sigurimit "Sigal Uniqa Group Austria" sh.a.**

2. **Miratimin e z. Etmond Bajraktari, për ushtrimin e veprimtarisë së agjentit në sigurime për klasat e Jo-Jetës, në emër dhe për llogari të subjektit "Bajraktari Mob" sh.p.k.**

3. **Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve për njoftimin në zbatim të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR	**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV**
Pajtim MELANI	**Ervin KOÇI**